




REPUBLICA E KOSOVËS	KOMUNA E VUSHTRRËS	VUHTRRI
01 Nr. / Br.	151/17	
Nr. i fq. / Br. si	-4-	
Datu / Datum	25. 5. 2017	
VUSHTRRI		



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

EKSTRAKT

LIDHUR ME RRJEDHËN E MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 24 PRILL 2017

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës, duke filluar në orën 10:07.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri:

Adnan Klinaku, Agim Bregaj, Agron Përçuku, Ali Januzi, Arta Ismajli, Bahrije Pllana, Ergin Sunguri, Fakete Dushi, Habib Mustafa, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Isa Hajrizi, Mehmet Selaci, Mentor Ferizi, Mirjeta Salihu, Melihate Basholli. Muharrem Shabani, Myrvete Hetemi, Qerim Selimi, Rahim Ajeti, Sabri Ferati, Safet Idrizi, Safet Osmani, Selim Rustemi, Selvete Sholla, Syzana Syla, Shaban Beka, Shkelzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Tasim Gubetini, Xhevahire Selmani dhe Zoran Rakiç.

Mungoi: Mejreme Ismajli

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së përfaqësuesit e mediave të shkruara dhe elektronike dhe përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Shpëtim Zhegrova – kryesues i kuvendit, i cili vërtetoi se ka shumicë për punë dhe përmarrjen e vendimeve të plotfuqishme.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – në hapje të mbledhjes, njoftoi se në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale rendi i ditës në mbledhjet e jashtëzakonshme nuk mund të ndryshohet. Tutje lidhur me këtë mbledhje sqaroi se, kërkesa për mbledhjen e jashtëzakonshme e bërë nga 1/3 e anëtarëve të kuvendit është pranuar në sekretarinë e kuvendit me datën 18 prill (ditë e martë), dhe njoftoi se disa anëtarë të kuvendit përmes telefonit kanë kërcënuar zyrtarët e sekretarisë së kuvendit, por edhe asistentin e kryesuesit të kuvendit të komunës. Pastaj shtoi se kërkesa për mbledhje ka ardhur pasditen e datës 18 prill, ku kryesuesi i kuvendit kishte qenë në një vizitë në Republikën e Shqipërisë, dhe nuk kishte pasur mundësi që atë ditë të nënshkruajë ftesën për mbledhje të jashtëzakonshme. Andaj si rezultat i kësaj ai këtë ftesë e kishte nënshkruar ditën e nesërme, dhe për këtë ai nuk mund të konstatojë se a jemi në rregull apo jo lidhur me afatin ligjor të thirrjes së kësaj mbledhjeje përfaktin se këtë çështje e vlerëson dhe konstaton MAPL-ja. Andaj në fund tha se nuk është mirë që të thirret në telefon sekretaria e kuvendit vend e pa vend duke ushtruar presion ndaj tyre, dhe njoftoi se ai atë ditë kishte arrit në Vushtrri nga ora 16:20, kur kishte përfunduar orari i punës, në këtë rast mbledhja është thirrur, dhe për këtë janë afatet ligjore dhe nëse dikush dëshiron ta kontestojë këtë, është çështje e tij apo është çështje individuale dhe grupore e secilit dhe jo e dikujt tjetër.

Rahim Ajeti, anëtar i kuvendit – tha se kjo mbledhje nuk është thirrur brenda afateve ligjore që i përcakton ligji dhe rregullorja e punës së kuvendit, andaj propozoi që kjo mbledhje të shtyhet, dhe mbledhja tjetër të thirret me datën 4 maj 2017.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se është bërë hera e pestë që thirret mbledhja e jashtëzakonshme lidhur me aprovimin e Draft-Planit Zhvillimor Komunal të Komunës së

Vushtrrisë 2016-2024, kurse herën e fundit është anuluar mbledhja për shkak të shkeljeve ligjore dhe kjo që ka ndodhur “është bërë shumë mirë” për faktin se qytetarët tanë nuk dëshirojnë të kenë vendime të dyshimta por iu duhen vendime konkrete. Andaj në këtë rast ju si kryesues i kuvendit, por edhe zyra ligjore duhet t'i përbaheni afateve ligjore dhe kjo mbledhje të shtyhet dhe e njëjtë të thirret për një datë tjeter, përfaktin se prapë do të kemi një kërkesë të tillë dhe do të qëndrojnë prapa vendimeve që i kanë marrë më herët. Mandej ceku se ata që kanë thirrur në telefon për të ushtruar presion duhet të paraqiten dhe që anëtarët e kuvendit të mos akuzohen njëri me tjetrin. Tutje vlerësoi që kur dikush zgjidhet kryetar i komunës ose anëtar i një forumi ai atëherë nuk duhet t'i takojë “partisë” por qytetarëve dhe ceku se tani është bindur se kjo nuk ekziston. Në fund tha qëndron prapa asaj se anëtarët e kuvendit nuk i përfaqësojnë partitë politike kah kanë ardhur, por i përfaqësojnë qytetarët duke e respektuar aspektin ligjor.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se në bazë të ligjit janë të përcaktuara dy mënyra për thirrjen e mbledhjes së jashtëzakonshme dhe atë: me kërkesën e kryetarit të komunës dhe me kërkesën e 1/3 së anëtarëve të kuvendit, pastaj është në drejtëni e kryesuesit të kuvendit, zyrës ligjore dhe sekretarisë së kuvendit që të përcaktohet data e mbajtjes së mbledhjes. Andaj në rastin konkret ne me anë të kërkesës suaj ai ishte kufizuar pasi i ishte përcaktuar data e mbajtjes së mbledhjes, pasi që data ishte përcaktuar nga vet anëtarët e kuvendit, në të kundërtën e kësaj, përcaktimi i datës së mbajtjes së mbledhjes dhe respektimi i afatit ligjor do të ishte në përgjegjësi të kryesuesit të kuvendit.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se çështje e kësaj teme është bërë histori, dhe i ka tejkaluar kufijtë e normales, dhe kjo tregohet me vetë faktin se që disa herë tentohet të aprovohet ky dokument dhe prapë dështon. Tutje shtoi se ky plan është shumë i rëndësishëm për komunën tonë me të gjitha parametrat e zhvillimit të përgjithshëm të komunës. Por çështja e aprovimit të këtij dokumenti ka marrë disa mbledhje, përkatësisht pesë herë kuvendi është mbledhur për të shqyrtuar këtë dokument, dy herët e para ishin bërë plotësimet e nevojshme të kërkuara nga ana e këtij kuvendi, një herë tjetër ishte aprovuar pa kuorum, mandej një herë tjetër nuk ishin zbatuar dispozitat ligjore lidhur me informimin e publikut nga shërbimet e administratës komunale, kurse tani kemi mosrespektim të afatit ligjor për dërgim të ftesës për mbledhje. Mandej shtoi se kërkesa për mbledhje të jashtëzakonshme është dërguar në zyrën pritëse (arkivin) e komunës, dhe ka interpretim të ndryshme sa i përket pranimit të kësaj shkrese. Andaj lidhur me këto ai vlerësoi se shumica janë që ky plan të aprovohet, por këtu dikush ka tendencia që aprovimi i këtij dokumenti të dështojë. Lidhur me këtë dokument ai ceku se është mirë që i njëjti të aprovohet dhe t'u jepet mundësia e barabartë të gjithë qytetarëve për zhvillimin e veprimtarive të tyre. Andaj duke u bazuar në afatet prekluzive, kërkoi që kuvendi me votë të deklarohet për shtyrjen e kësaj mbledhjeje, dhe caktimin e një mbledhjeje tjetër të jashtëzakonshme brenda afatit tri ditë pune me të njëjtin rend dite, ku këtë duhet ta bëjë kryesuesi i kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se mbledhjet e jashtëzakonshme nuk mund të shtyhen dhe kërkoi që kjo mbledhje të konsiderohet si e dështuar, dhe të bëhet kërkesa tjetër për një mbledhje të re.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – tha se kuvendi i komunës është shndërruar në një “cirk” dhe për këtë të gjithë anëtarët e kuvendit duhet të kenë “turp”. Tutje shtoi se që nga fillimi në këtë dokument disa gjëra janë bërë me tendenza të caktuara, dhe pikërisht për këtë kemi ardhur deri në këtë pikë. Pastaj përsëriti si edhe në të kaluarën në emër të grupit kuvendar të LDK-së, që për shkak të rëndësisë që ka ky dokument do duhej të aprovohej me konsensus politik. Mirëpo ne si anëtarë të kuvendit jo që nuk e aprovuan dhe nuk gjetëm konsensusin e duhur, por filluam të akuzohemi njëri me tjetrin, dhe kështu vetëm sa po dëmtohen interesat e qytetarëve. Tani kuvendi po merret me gjëra tepër formale, dhe kjo po bënë punën e kuvendit tepër joserioze dhe kësisoj kuvendi është shndërruar në “cirk”. Ai ceku se është që të respektohen afatet ligjore, por jo që të vihen në rend të parë tendencat që e zhvlerësuan punën e

kuvendit. Andaj ai rikonfirmoi, se prapë do të ketë nënshkrime për mbledhje tjetër dhe në emër të grupit të LDK-së, kërkoi që kjo mbledhje të shtyhet dhe të caktohet një mbledhje brenda afateve ligjore.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – pyeti se ku ndodhen anëtarët e qeverisë komunale, duke filluar nga kryetari i komunës që nuk janë prezent në mbledhjen e kuvendit. Duke e ditur rëndësinë e këtij dokumenti, si dhe punën e madhe që është lidhur me të, është dashur që përfaqësuesit e qeverisë komunale të janë sot këtu në këtë mbledhje. Tutje shtoi se që nga fillimi kishin kërkuar që me qëllim të mosrrezikimit të buxhetit të komunës, është kërkuar që zona e tetë të jetë e patrajtuar deri në zgjidhjen e kontestit gjyqësor. Andaj në këtë rast ai i adresoi pyetje ekzekutivit komunal, se a rrezikohet buxheti i komunës në qoftë se miratohet ky plan zhvillimor. Në qoftë se nuk rrezikohet buxheti i komunës, atëherë ata janë për aprovimin e këtij plani ashtu si është ofruar nga ana e ekzekutivit. Pastaj shtoi se ky dokument mjaft me peshë nuk e ka vetëm një zonë, por i ka afër 37 zona, dhe shtoi se edhe në fillim kishte deklaruar që është mirë që hartuesi i këtij plani duhet të jetë këtu që të japë sqarime zonë për zonë për krejt këtë dokument, për shkak se nuk është vetëm zona e tetë, por janë edhe zonat tjera, të cilat për të janë mjaft të paqarta. Pastaj ceku se pa u sqaruar këto gjëra, nuk ka kuptim aprovimi i këtij plani, dhe vlerësoi se çështja e votimit është vullnet i lirë i secilit dhe për këtë nuk duhet të “hidhërohem” njëri me tjetrin, mirëpo nëse në kuadër të aprovimit të këtij dokumenti do të mund të gjobitej komuna me afro 4 milionë euro, atëherë cili është interes i për këtë dhe për këtë secili të votojë sipas bindjes së tij të lirë. Në këtë kontekst vlerësoi se i intereson prononcimi i ekzekutivit komunal lidhur me çështjet e apostrofuara më lart. Në fund sërisht bëri thirrje që të gjitha grupet kuvendare dhe ekzekutivi të gjejnë një konsensus lidhur me aprovimin e këtij plani.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se nëse kemi mospërmbajtje të afateve ligjore, atëherë është e pakuptimtë, që të diskutohet këtu sepse edhe nëse vendoset kjo çështje prapë ministria do ta shpallë të pavlefshme këtë mbledhje. Andaj në këtë rast kërkoi ngaqë kjo mbledhje të shtyhet, dhe të kemi një mbledhje tjetër ku do të respektohen të gjitha afatet ligjore. Tutje shtoi se qe pesë herë radhazi dështon aprovimi i këtij plani dhe kemi “heshtje” të organeve kompetente gjykatës dhe prokurorisë. Andaj në këtë rast duhet të bëhet e ditur se kujt po i konvenon që kjo çështje të zvarritet se kujt po i preken interesat dhe çështje tjera. Në fund publikisht ftoi organet e drejtësisë që të bëjnë punën e tyre dhe ta zbardhin këtë çështje.

Mentor Ferizi, anëtar i kuvendit – tha kur bëhet fjalë për vlerën e kontestit gjyqësor në vlerë mbi 4 milionë euro, për pronën e stacionit të autobusëve, atëherë duhet marrë për bazë se në këtë rast kemi një vendim të formës së prerë nga gjykata, dhe po në këtë rast pronarëve të atyre pronave duhet t'u jepet mundësia e ndërtimit ashtu që këta pronarë të heqin dorë nga padia dhe në këtë formë do të lirohej komuna nga barra e borxheve ndaj këtyre pronarëve. Pastaj shtoi se zona ku ndodhet stacioni i autobusëve është tepër e kontaminuar dhe aty nuk ka arsy që të ndalohet ndërtimi.

Shpëtim Zhegrova, kryesues i kuvendit – tha se grupi kuvendar i PDK-së, ka pasur dhe ka qëndrimin se do ta votojë PZHK-në, nëse do të hiqet shenja e stacionit të autobusëve, dhe kështu do t'u jepej mundësia pronarëve që të ndërtojnë dhe në të njëjtën kohë do të pezullohej ekzekutimi i vendimit gjyqësor që e ngarkon komunën me borxhe financiare. Në fund tha se në këtë mënyrë do hiqej dorë nga të gjitha paditë gjyqësore dhe komuna do lirohej nga obligimet, kurse e gjithë zona e tetë do të mbetej zonë ndërtimore dhe kështu do të mund të aprovohej Plani Zhvillimor Komunal.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se askush nuk është që të shkelet ligji dhe shtroi pyetjen se kush dha vendimin për rrënimin e objektit dhe shkatërrimin e pronës së stacionit të autobusëve, ku në atë pronë është bërë demolomi i objektit dhe sikur është përgatitur terreni për një ndërtim të ri. Mandjej lidhur me emërtimin e urës së gurit, ceku se kjo çështje nuk i takon kuvendit, dhe shtoi se ish-kuvendi i komunës i kishte dërguar materiale delegacionit shqiptar në Vjenë gjatë bisedimeve për statusin e Kosovës, dhe kjo është vendosur ashtu si është vendosur

atëherë dhe tani kjo çështje nuk i takon kuvendit të komunës. Në fund ceku se prapë do të shtrohet kërkesa për mbledhje të jashtëzakonshme nga 1/3 e anëtarëve të kuvendit.

Safet Idrizi, anëtar i kuvendit – tha se që nga fillimi grupi kuvendar i PDK-së ka qenë që zona kontestuese të mbetet e patrajtuar deri në një afat të caktuar, që do të gjendej një zgjidhje e kontestit lidhur me ato prona. Pastaj ceku se nuk është që të dëmtohet asnje biznes, dhe shtoi se çështja kyçë është që mos të penalizohet komuna me gjobë (borxhe), kurse ajo se çfarë mbetet ajo zonë nuk ka shumë rëndësi dhe se nëse vlerësohet se ajo zonë duhet të mbetet ndërtimore atëherë le të mbetet e tillë. Në fund përsëriti për gjetjen e konsensusit për votimin e këtij dokumenti.

Hysni Gërguri, anëtar i kuvendit – tha se debati lidhur me PZHK-në është shtetur dhe për këtë janë përfunduar të gjitha procedurat ligjore duke filluar që nga diskutimi publik, dhe tani pas përfundimit të të gjitha këtyre punëve nuk ka nevojë që e njëjtë punë të fillojë prej fillimit. Në fund kërkoi që në hedhet në votim shtyrja e mbledhjes dhe të thirret një mbledhje tjetër në suaza të ligjit.

Rahim Ajeti, anëtar i kuvendit – tha se kërkesa për thirrje të mbledhjes së jashtëzakonshme është parashtruar më datë 18 prill në ora 11:10, si dhe kërkoi që kjo mbledhje të ndërpritet për shkak të mosrespektimit të afatit.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se ekzekutivi komunal e ka dhënë mendimin e vet sa i përket pronës së stacionit të autobusëve, duke e tërhequr vendimin e nënshkruar më herët dhe këtë kryetari i komunës e ka përsëritur disa herë. Më vonë këto prona të kësaj ndërmarrjeje kanë kaluar në kontest, dhe për këtë grupi kuvendar i PDK-së ishte pajtuar që kjo zonë të mbetet e patrajtuar deri në gjetjen e një zgjidhjeje, por më vonë kjo temë ishte ndryshuar. Tani komuna, është tërhequr nga pronësia e kësaj ndërmarrjeje dhe ka mbetur një pjesë e pronës e paprivatizuar dhe faktikisht më nuk kemi stacion të autobusëve. Në fund tha se nëse nuk janë respektuar afatet ligjore, atëherë mbetet në dorën e kryesuesit të kuvendit që ta vendos këtë mbledhje se a do të ndërpritet apo do të përfundohet, por përsëri nga 1/3 e anëtarëve të kuvendit do të ketë kërkesë për mbledhje të re.

Mehmet Selaci, anëtar i kuvendit – tha se kjo temë e PZHK-së është bërë demode dhe vlerësoi se VV në Vushtrri është dashur të marrë veprime tjera më të ashpra (të hedh gaz lotsjellës në kuvend).

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit – tha se kjo mbledhje, duhet të shtyhet dhe për këtë të konstatohet se shërbimet e administratës nuk kanë vepruar me kohë lidhur me thirrjen e kësaj mbledhjeje dhe njoftoi se tërhiqet nga kërkesa e nënshkruar për mbledhje, kurse veprimet e tij çfarë do të jenë do të dihen në të ardhmen.


Në fund të diskutimeve të anëtarëve të kuvendit, kuvendi me 12 vota “kundër”, të tjerat “abstenim” nuk e aprovoi këtë:

RENDITE


1. Shqyrtimi i Draft-Planit Zhvillimor Komunal i Komunës së Vushtrrisë 2016-2024.

Mbledhja përfundoi në orën 11:20.

Bastri Duraku


Procesmbajtës

Shpëtim Zhegrovë


Kryesues i Kuvendit